

Nr. 60 Prot.

Dt. 08/04/2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Dhe

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN

Universiteti EUropian i Tiranës, (në vijim UET), me adresë në Bulevardi Gjergj Fishta Nd. 70 H.1, Njësia Bashkiake Nr.7 Tiranë, i përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Tonin Gjuraj**, pajtohen të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

dhe

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, (në vijim UKZ) u themelua me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 118/03 të datës 6 mars 2013, i cili nga Kuvendi i Kosovës u miratua më 30 maj 2013, me idenë e promovimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë universitar, me adresë rr."Zija Shemsiu" pn. 60000 Gjilan i përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Bajram KOSUMI**
Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes:

Më këtë Marrëveshje palët nënshkruese shprehin gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjelltë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale e akademike, të kapaciteteve të stafit dhe studentëve si dhe përmirësimin e proceseve akademike. Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithmbarshëm edukativ të dy institucioneve.

Rekomandimet dhe ekspertiza profesionale janë të nevojshme veçmas në: idetë, projektet rajonale dhe ndërkombëtare, pilot -projektet dhe programet e caktuara që kanë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë marrëveshje.

Neni 2

Forma e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet dy Universiteteve do të përfshijë:

1. Shkëmbimi i përvojave akademike, me qëllim arritjen e standarteve bashkëkohore në fushat e ndryshme universitare;
2. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme shkencore, ekonomike, politike dhe kulturore nëpërmjet simpoziumeve, konferencave e debateve;
 - a. Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;
 - b. Shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
 - c. Lehtësim të procedurave të transferimit të studentëve midis universiteteve;
 - d. Mbështetje për zhvillimin dhe përmirësimin e praktikave profesionale në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve;
 - e. Shkëmbimi i literaturës shkencore dhe të përvojës së menaxhimit institucional;
 - f. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
 - g. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
 - h. Institucionalizimin e bashkëpunimit reciprok dhe të ndërsjellë në sferën e ofrimit të ndihmës për ngritjen e kapaciteteve të studentëve të këtyre universiteteve;
 - i. Bashkëpunimin në organizimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve rajonale dhe ndërkombëtare me interes të përbashkët;
 - j. Bashkëpunimi si partnerë në projekte të ndryshme rajonale e ndërkombëtare me fokus arsimin e lartë, kryesisht në Erasmus +, Horizon 2020 etj. për të cilat do të mundësohet përfshirja e pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës në aplikim dhe zbatim të këtyre projekteve
 - k. Shkëmbimin e eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve;

- l. Zhvillimin e programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore, dhe projekteve të tjera të cilat janë me interes të dy institucioneve;
- m. Organizimin e përbashkët të konferencave, trajnimeve, seminareve dhe bashkëpunimeve të tjera profesionale;

Neni 3 **Financat**

Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-m) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga i ngarkuari i Rektorit, nga secili Universitet. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

Neni 4 **Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë dhe për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve do të bëhen diskutime paraprake. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si në vijim:

- Mosmarrëveshjet eventuale palët do të përpiqen që t'i tejkalojnë me mirëkuptim;
- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;

Marrëveshja mund të prishet nëse palët e argumentojnë se e njëjta nuk mund të funksionojë sipas frymës së saj;

Neni 5

Përdorimi i informacionit dhe dokumentacioni

Palët pajtohen që cdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara në këtë dokument. Palët nuk mund të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna të ndonjërës palë për qëllime të tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje apo që mund të bien ndesh me të, pa aprovim paraprak të palës tjetër.

Neni 6

Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy Universitetet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Neni 7

Standardet dhe Konfidencialiteti

Të dyja palët janë të detyruara të përmbushin këtë Marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë. Asnjëra nga palët nuk do t'i përdorë dhe nuk do t'ju tregojë të tretëve informacionet konfidenciale të palës tjetër apo informacionet e përbashkëta përveç informacioneve.

Neni 8


Zgjidhje e Mosmarrëveshjeve

Cdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është përpiluar në 4 kopje identike; secila palë merr nga dy kopje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje përmban 4 (katër) fletë dhe hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe dy për secilën palë dhe pasi lexohet, firmoset nga Rektorët përkatës.

PËR: UNIVERSITETIN EUROPIAN TË TIRANËS		PËR: UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA", GJILAN	
Emri:	Prof.Dr.Tonin Gjuraj	Emri:	Prof.Dr. Bajram KOSUMI
Pozita:	Rektor	Pozita:	Rektor
Nënshkrimi/Vula:	 	Nënshkrimi/Vula:	 
Data/ Vendi:	09/04/2021 Tiranë	Data/ Vendi:	09/04/2021 Tiranë
Protokoli:		Protokoli:	01/798